

Njoftim për përqendrim me të cilin Schwarz New Ventures GmbH, Gjermani dhe Axel Springer SE, Gjermani do të fitojnë kontroll të përbashkët mbi Dyn Media GmbH, Gjermani dhe me të cilin Schwarz New Ventures GmbH, Gjermani dhe Axel Springer SE, Gjermani do të themelojnë një ndërmarrje të përbashkët me funksione të plota Dyn Productions NewCo GmbH

(lënda nr. 08-118 /2025)

Në përputhje me nenin 15 të Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 145/10, 136/11, 41/14, 53/16 dhe 83/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" 208/24), më datë 25.07.2025, në Komisionin për Mbrojtjen e Konkurrencës është dorëzuar një njoftim për përqendrim që i referohet fitimit të kontrollit të përbashkët mbi Dyn Media GmbH me seli të regjistruar në Universitätsstraße 71, 50931 Köln, Gjermani nga ana e Schwarz New Ventures GmbH me seli të regjistruar në Stiftsbergstraße 1, 74172 Neckarsulm, Gjermani dhe Axel Springer SE me seli të regjistruar në Axel-Springer-Straße 65, 10888 Berlin, Gjermani dhe themelimit të një ndërmarrjeje të përbashkët me funksione të plota (Dyn Productions NewCo) mbi të cilën kontroll të përbashkët do të kenë Schwarz New Ventures GmbH, Gjermani dhe Axel Springer SE, Gjermani.

-Schwarz New Ventures është një shoqëri thjesht holding pa aktivitete të pavarura biznesi. Schwarz New Ventures është një shoqëri e varur në mënyrë indirekte nga Schwarz Corporate Solutions KG, e cila është pjesë e Grupit Schwarz.

Grupi Schwarz është një grup ndërkombëtar shoqërish me fokus në shitjen me pakicë të ushqimit. Përmes divizioneve të tij Lidl (shitje me pakicë ushqimore me zbritje) dhe Kaufland (shitje me pakicë ushqimore në shkallë të gjerë), Grupi Schwarz është kryesisht aktiv në sektorin e shitjes me pakicë të ushqimit në 32 vende. Me PreZero, divizioni për menaxhimin e mbeturinave, Grupi Schwarz është gjithashtu një ofrues i integruar i shërbimeve në fushën e menaxhimit të mbeturinave, grumbullimit, klasifikimit, përpunimit dhe riciklimit të mbeturinave. Përveç kësaj, divizioni i prodhimit i Grupit Schwarz prodhon produkte të ndryshme ushqimore në fabrikat e veta dhe ambalazhon ujë mineral dhe pije të ëmbla. Divizioni i IT-së dhe digjital, Schwarz Digits, i Grupit Schwarz ofron gjithashtu produkte dhe shërbime digjitale.

Në Maqedoninë e Veriut, Grupi Schwarz është i pranishëm përmes një shoqërie të varur të regjistruar - **LIDL SEVERNA MAKEDONIJA SHPKNJ**, me seli të regjistruar në bul. Kiro Gligorov nr. 2, kati 3, 1000 komuna Gazi Babë, Shkup. Shoqëria aktualisht nuk është aktive, por pritet të fillojë me punë në të ardhmen e afërt, d.m.th. do të menaxhojë marketet LIDL në Maqedoninë e Veriut.

-Axel Springer është një grup mediatik ndërkombëtar, me seli në Berlin, Gjermani. Grupi ofron kryesisht media lajmesh (të shtypura dhe digjitale), printimin dhe publikimin e reklamave, portofol të klasifikuar digjital, modele marketingu dhe shërbime të ngjashme. Veprimtaria e Axel Springer është e ndarë në News Media dhe Marketing Media.

Brendet mediatike të Axel Springer përfshijnë Bild, Business Insider, Morning Brew, POLITICO dhe Welt, ndërsa në portofolin e tyre përfshihen edhe shoqëritë e marketingut Awin, Bonial dhe idealo, si dhe instituti për hulumtimin e tregut digjital Emarketer. Në Poloni, Axel Springer ka një ndërmarrje të përbashkët me shoqërinë mediatike Ringier, e cila përfshin brendet mediatike Fakt, Forbes, Newsweek dhe ONET.

Axel Springer nuk ka shoqëri të varura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut.

Dyn Media GmbH ofron shërbime për transmetimin e përmbajtjeve sportive me bazë abonimi, veçanërisht të ndeshjeve të hendbollit dhe basketbollit të ligave gjermane, të ashtuquajturat video sipas kërkesës (on-demand) me bazë abonimi. Dyn Media është aktualisht nën kontrollin e vetëm të Axel Springer.

Dyn Media nuk ka shoqëri të varura të regjistruara në Maqedoninë e Veriut dhe nuk ka realizuar asnjë të ardhur në Maqedoninë e Veriut në vitin 2024.

-Dyn Productions NewCo do të themelohet nga ana e Schwarz New Ventures GmbH, Gjermani dhe Axel Springer SE, Gjermani si pjesë e transaksionit të propozuar, me strukturë pothuajse të njëjtë të ortakërisë si Dyn Media. Pas themelimit, Dyn Productions NewCo do të prodhojë përmbajtje audio vizuale (për transmetim) për Dyn Media dhe palë të treta.

Sipas parashtruesit të njoftimit, tregjet përkatëse të mallrave për vlerësimin e përqendrimit të raportuar mund të definohen si: blerja dhe licencimi i të drejtave të transmetimit, shpërndarja me pagesë e përmbajtjeve audio vizuale, shitja e hapësirës reklamuese në kontekstin e prezantimit të përmbajtjeve audio vizuale, dhe prodhimi i përmbajtjeve audio vizuale.

Bazuar në shqyrtimin paraprak, Komisioni konstatoi se përqendrimi në fjalë mund të bie nën dispozitat e Ligjit për Mbrojtjen e Konkurrencës. Megjithatë, vendimi përfundimtar për këtë çështje është i rezervuar.

Komisioni fton palët e treta të interesuara të dorëzojnë vërejtjet dhe opinionet e tyre për këtë përqendrim në Komision. Vërejtjet dhe opinionet e palëve të treta të interesuara mund të dërgohen në adresën: rr. "Shën Kirili dhe Metodi" nr. 54, Shkup ose me e-mail: kzk@kzk.gov.mk dhe ato duhet të arrijnë në Komision brenda 10 ditëve nga dita e publikimit të këtij njoftimi.

31.07.2025

Shkup